



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEKANI**

Nr. 2892/11 Prot.

Tiranë, më 15 . 01 . 2025

VENDIM

Nr. 01 datë 15.01. 2025

**MBI KRITERET E PRANIMIT TË STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË DHE TË
DYTË TË STUDIMEVE NË FAKULTETIN E GJUHËVE TË HUAJA TË
UNIVERSITETIT TË TIRANËS
PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027**

Në zbatim të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 23, pika 4 të ligjit nr 80./2015 dt 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Dekanati i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja me vendim qarkullues më datë 15.01.2025, pasi diskutoi propozimet e përcjella nga Njësitë bazë të Fakultetit dhe në mbështetje të nenit 90 të Statutit të Universitetit të Tiranës

VENDOSI

1. Kanë të drejtë të aplikojnë për t’u pranuar në programet e studimit të ciklit të parë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja kategoritë e mëposhtme:
 - A) studentët që plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar sipas VKM-së nr. 403 datë 03.06.2020, ndryshuar me VKM-në nr. 46 datë 27.01.2021, ndryshuar me VKM-në nr. 363 datë 26.05.2022;
 - B) kandidatët që kanë një diplomë të shkollës së mesme ekuivalente të një vendi të huaj;
 - C) si dhe shtetasit e huaj në kushtet dhe mënyrat e parashikuara nga marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe
2. Për pranimet në ciklin e dytë të studimeve në vitin akademik 2026-2027 kriteret janë si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEKANI

- I. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve, **Master i Shkencave në:**

Mësuesi e Gjuhës Angleze për Arsimin e Mesëm të Lartë
Mësuesi e Gjuhës Frënge për Arsimin e Mesëm të Lartë
Mësuesi e Gjuhës Gjermane për Arsimin e Mesëm të Lartë
Mësuesi e Gjuhës Italiane për Arsimin e Mesëm të Lartë
Mësuesi në Gjuhën Greke për Arsimin e Mesëm të Lartë
Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë

1. Kandidatët që zotërojnë një diplomë në programin e studimit të ciklit të parë, në gjuhën përkatëse, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe/ose në programe të tjera të ciklit të parë, në gjuhën përkatëse, në universitetet publike dhe jopublike, vendase apo të huaja, të akredituara.
2. Kriter pranimi në programet *Master i shkencave në Mësuesi në Gjuhën Greke për Arsimin e Mesëm të Lartë* dhe *Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë* është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin.

Shënim: Renditja e fituesve do të bëhet sipas rendit zbritës së notës mesatare deri në plotësimin e kuotave të miratuara.

II. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve, **MASTER I SHKENCAVE NË: KOMUNIKIM NDËRKULTUROR DHE TURISTIK TRIGJUHËSH:**

1. Kandidatët që zotërojnë një diplomë në programin e studimit të ciklit të parë, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe/ose në programe të ngjashme të ciklit të parë, në universitetet publike dhe jopublike, vendase apo të huaja, të akredituara.
2. Kriter pranimi në këtë program studimi "*Master i Shkencave*" është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse individ ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

Shënim: Renditja e fituesve do të bëhet sipas rendit zbritës së notës mesatare deri në plotësimin e kuotave të miratuara.

III. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEKANI**

**MASTER I SHKENCAVE NË: PËRKTHIM TEKNIK-LETRAR DHE
INTERPRETIM**

1. Kandidatët që zotërojnë një diplomë në programin e studimit të ciklit të parë, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe/ose në programe të ngjashme të ciklit të parë, në universitetet publike dhe jopublike, vendase apo të huaja, të akredituara.
2. Kriter pranimi në këtë program studimi "*Master i Shkencave*" është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse individ ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

Shënim: Renditja e fituesve do të bëhet sipas rendit zbritës së notës mesatare deri në plotësimin e kuotave të miratuara.

**IV. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve,
MASTER PROFESIONAL NË PËRKTHIM ME PROFIL PËRKTHYES NË
GJUHË ANGLEZE:**

1. Kandidatët të kenë përfunduar programin e ciklit të parë të studimeve në një universitet të akredituar brenda apo jashtë vendit dhe të njohur nga MASR-ja.
2. Kriter pranimi në këtë program studimi "*Master i Shkencave*" është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse individ ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

Shënim: Renditja e fituesve do të bëhet sipas rendit zbritës së notës mesatare deri në plotësimin e kuotave të miratuara.

**V. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve, MASTER
I SHKENCAVE NË "TRAJTIMI AUTOMATIK I GJUHËVE":**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEKANI**

- a) Kandidatët që zotërojnë një diplomë në programin e studimit të ciklit të parë, në universitetet publike dhe jopublike, vendase apo të huaja, të akredituara.
- b) Kriter pranimi në këtë program studimi "Master i Shkencave" është njohja nga kandidati i gjuhës frënge dhe angleze vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

Shënim: Renditja e fituesve do të bëhet sipas rendit zbritës së notës mesatare deri në plotësimin e kuotave të miratuara.